



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Rregj Themeltar **7633/3037/869**
Data e rregjistrimit **01.10.2014**

Nr. Vendimit **1150**
Data e vendimit **12.05.2016**

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga gjyqtarët :

BARI SHYTI
LINDITA SINANAJ
AMARILDO LAÇI

Kryesues
Anëtare
Anëtar

Asistuar nga **sekretare Visela Kashari** ne Tirane më datën 12.05.2016 shqyrtoi në dhomë këshillimi, çështjen administrative me Nr. **7633/3037/869 Rregj Themeltar** me palë ndergjyqese:

PADITËS: Shoqeria “Shqiperia 2A” sh.p.k. me NIPT K66516202, me seli ne Vlore, lagjia: “28 Nentori” tek ish NTAN, perfaqesuar nga administratori Arta Xhelaj.

TE PADITUR: **1.Drejtoria Rajonale Tatimore, Vlore**
2.Drejtoria e Apelimit Tatimor, Tirane.

OBJEKTI: 1. Anullim i aktit administrativ Njoftim Vleresimi Nr.1293, date 23.01.2012 dhe Nr.4520, date 19.09.2012, si dhe Vendimet e Drejtorise se Apelit Tatimor Nr.3171/1, date 29.01.2012 dhe Nr.23569/1, date 04.12.2012

BAZA LIGJORE: Nenet 324, 328, te K. Pr. Civile, si dhe neni 106 e vijues te Ligjit 9920, date 19.05.2008 “Per procedura tatimore ne Republiken e Shqiperise.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore pasi ka shqyrtuar pretendimet e pales paditese, ka analizuar provat e marra ne seance gjyqesore, ne interpretim te ceshtjeve te faktit dhe te ligjit me **Vendimin nr.2269 date 16.10.2013** ka vendosur:

- *Pranimin e kerkese padise*
- *Anullimin e Aktit Administrativ, Njoftim Vleresimi Tatimor Nr.1292, date 23.01.2012 leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore.*
- *Anullimin e Aktit Administrativ, Vendim Nr.3171/1, date 29.01.2012 leshuar nga Drejtoria e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve.*
- *Anullimin e Aktit Administrativ, Njoftim Vleresimi Tatimor Nr.4520, date 19.09.2012 leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore.*
- *Anullimin e Aktit Administrativ, Vendim Nr.23569/1, date 04.12.2012 leshuar nga Drejtoria e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve.*
- *Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen pales se paditur.*

Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur ankim pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore, e cila eshte vene ne dijeni te vendimit nepermjet defteses se komunikimit me dt.22.10.2013, dhe me ane te te cilit kerkon ndryshimin e vendimit te gjykates se shkalles se pare dhe rrezimin e padise.

Shkaqet e parashtruara ne ankim nga pala e paditur .

- ✓ Vendimi i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore ka ardhur si rezultat i zbatimit keq te ligjit material.
- ✓ Nga aktet rezulton se shoqeria Shqiperia 2A sh.p.k, e cila u shtron aktivitet ne qytetin e Vlores, gjate ushtrimit te kontrollit tatimor nga ana e inspektoreve gjate ushtrimit te detyrave te tyre funksionale kane mbajtur akt konstatimet nr.0161774, date 22.12.2011, dhe nr.0292751, date 24.08.2012 ne baze te te cilave kane dale edhe proces verbalet e gjobave ne masen 500.000 leke, per mos leshimin e kuponit tatimor. Mbi baze e ketyre akteve Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore ka nxjerre Njoftim Vleresimet tatimore nr.1293 dhe 3171/1. Persa i perket Njoftim Vleresimit per detyrimet Nr.1293, date 23.01.2012 me te drejte Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane ke lene ne fuqi kete akt pasi ne nenin 122 pika 1/b/i te ligjit 9920, date 19.05.2009 Per Procedurat Tatimore ne RSH, thuhet se tatimpaguesi person juridik, fizik tregtar denohet ne rast se; nuk leshon kuponin tatimor per qarkullimin e realizuar te mallrave apo sherbimeve per cdo rast konstatimi. Heren e pare me gjobe 200.000 leke per tatimpaguesit e rregjistruar si subjekte te TVSH-se dhe TF, dhe gjobe ne masen 100.000 leke per tatim paguesit e tjere.
- ✓ Ne lidhje me Njoftim Vleresimin nr.4520, date 19.09.2012 te Drejtorise Rajonale Tatimore Vlore theksojme se nuk duhej marre parasysh nga Gjykata pasi paditesi nuk ka

ezaauruar rrugen administrative brenda afateve ligjore dhe me te drejte Drejtoria e Apelimit Tatimor ka refuzuar ankimin e tatimpaguesit.

- ✓ Si perfundim kerkojme nga Gjykata perishjen e Vendimit Nr.2269, date 16.10.2013 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore duke vendosur rrezimin e padise si te pambeshtetur ne prova dhe ne ligj.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore ka percjelle aktet per kompetence funksionale Gjykates se Apelit Vlore.

Gjykata e Apelit me Vendim Nr.931/60-2-14-1283, date 22.05.2014 ka shpallur moskompetencen e saj per gjykimi e kesaj ceshtje duke derguar aktet per kompetence gjykimi ne Gjykatën Administrative te Apelit per shkak te fillimit te funksionimit te Gjykateve Administrative ne daten 04.11.2013.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Si degjoi relatimin e ceshtjes nga Gjyqtari Bari Shyti, shqyrtoi shkaqet e ngritura ne ankim dhe diskutoi ne teresi ceshtjen :

VEREN

Se vendimi Nr. 2269 date 16.10.2013 , i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlore , është rrjedhojë i zbatimit te gabuar të ligjit dhe analizës se jo të saktë të provave të marra në shqyrtimin, për pasojë në aplikim te nenit 50 germa “c”, të ligjit Nr. 49/2012 ai duhet të ndryshohet nga Gjykata Administrative e Apelit dhe të rrezohet padia.

A. Rrethanat e Ceshtjes

Nga shqyrtimi i provave shkresore te administruara ne dosjen gjyqësore, rezulton se Shoqeria “Shqiperia 2A” sh.p.k. me NIPT K66516202, me seli ne Vlore, eshte shoqeri e rregjistruar ne rregjistrin e shoqerive si person juridik, ushtron aktivitetin e saj ne fushen tregtare duke iu nenshtruar zbatimit te legjislacionit Shqiptar. Ajo ushtron aktivitetin e saj ne tregetim mallrash te ndryshme e perfaqesuar nga administratorja e shoqerise znj. Arta Xhelaj.

Nga ana e inspektoreve te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Tirane, mbi baze akt konstatimeve me nr.0161774, date 22.12.2011 dhe me nr.0292751, date 24.08.2012 eshte sanksionuar me gjobe shoqeria “Shqiperia 2A” sh.p.k per arsye se ky subjekt ben shitje me pakice pa leshuar kupon tatimor (shitje nga mjeti furgon Ford me targe VL 9612 C) fakt ky i cili ne kuptim te ligjit perben shkelje tatimore administrative. Per keto fakte kane dale aktet respektive te shoqeruara me procesverbalet perkatese; ai me nr.0053751, date 22.11.2011 per gjoben ne masen 200.000 leke dhe ai me nr.0157319, date 24.08.2012 per gjoben ne masen 300.000 leke.

Mbi baze te ketyre akteve te sipercituara Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlore, ka nxjerre njoftim vleresimet tatimore me nr.1292, date 23.01.2012 dhe nr.11520, date 19.09.2012 me te cilet pala paditese e ketij gjykimi detyrohet te paguaje “Detyrimin e vleresuar me siper” ne total 500.000 leke.

Paditesi shoqeria "Shqiperia 2A" sh.p.k, pasi ka marrë dijëni për detyrimet, i është drejtuar Drejtorise së Apëlimit Tatimor me kërkesë për apëlim, datë 14.02.2012, Për anulimin e njoftim vleresimit Nr.1293, datë 23.01.2012 si të pambeshtetur në ligj. Drejtoria e Apëlimit Tatimor pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën, me Vendim Nr.3171/1 Prot., datë 29.01.2012, vendosi; *Lenien në fuqi të aktit administrativ, objekt ankimi administrativ, Njoftim Vleresimi për Detyrimet Tatimore, Nr.1293, datë 23.01.2012, të DRT Vlorë, dhe rrezimin e ankimit.*

Paditesi shoqeria "Shqiperia 2A" sh.p.k, ka kundërshtuar në Drejtorinë e Apëlimit Tatimor me kërkesë për apëlim, datë 10.10.2012, edhe njoftim vleresimin Nr.11520, datë 19.09.2012, duke pretenduar se edhe ky akt është i pambeshtetur në ligj. Drejtoria e Apëlimit Tatimor pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën, me Vendim Nr.23659/1 Prot., datë 04.12.2012, vendosi; *Refuzimin e ankimit në lidhje me anulimin e penaltetit prej 300.000 leke, për periudhën tatimore 2012/08, njoftuar me aktin administrativ, Njoftim Vleresimi për detyrimet Nr.4520 prot. Datë 19.09.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, për kundravajtjen administrative të konstatuar, për arsye se e konsideron ankimin të papranueshëm pasi i ka kaluar afati i ankimit administrativ tatimor.*

Pasi ka ezauruar ankimin administrative, paditësi ka ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku ka kërkuar shfuqizimin e akteve administrative Njoftim Vleresimet për Detyrimet Tatimore me nr.1292, datë 23.01.2012 dhe nr.4520, datë 19.09.2012 të DRT Vlorë si akte relativisht të pavlefshme.

Pretendimet e palës padites gjate gjykimit ne shkalle te pare.

- Fatura tatimore nuk është trajtuar në asnjë rast prej inspektorit dhe është pikerisht ky elementi që tregon subjektivizmin e penalizimit të padrejtë të bërë për shoqerinë . Nëse kontrolli do të konstatonte një shitje, inspektorët fillimisht duhet të trajtonin faturën tatimore e cila përmban të dhënat e percaktuara në nenin 36 me siper dhe me pas mund të trajtonin mënyrën e pagesës pasi sipas legjislacionit tatimor likuidimi midis subjekteve nuk mund të bëhet në të gjitha rastet me CASH, por mund të bëhet edhe nëpërmjet transfertave bankare gje e cila ndodh në shumicën e rasteve sipas SKK. (Standartet Kombëtare të Kontabilitetit). Pra nëse subjekti ynë kryen një shitje me pagesë të mëvonshme kjo shitje në kontabilitetin financiar njihet si shitje por nga ana tjetër pasohet nga një regjistrim, si klient të subjektit bleres, pra në cdo rast kemi një regjistrim të dyfishtë. Në datën 24.08.2012 sipas librit të shitjeve të deklaruar në organet tatimore nuk kemi realizuar asnjë shitje drejt subjektit tregtar të përmendur në akt-konstatim.
- Nëse do të kishte ndodhur që subjekti jonë të mos kishte leshuar fature tatimore e cila në subjektet tregtare është e detyrueshme në cdo rast atëherë inspektorët do të mërrnin masën sipas ligjit a) me konfiskim b) me mosleshimin e fatures tatimore.

- Mosleshimi i kuponit nuk perben shkelje me vete por eshte rrjedhoje e likujdimit te fatures tatimore ne te gjitha rastet e shitjes ne subjektet tregtare. Inspektoret tatimore ne menyre te padrejte e kane percaktuar reklamimin e mallit te bere ne ambientet e znj.Zamira Doko, si shitje pa kupon.
- Reklama nuk perben shitje por vetem nje njohje te produktit dhe cilesive te tij pa prekur aspektin e pronesise se mallit. Pra inspektoret pa asnje lloj argumenti dhe bazueshmerie ligjore mbi faktet e nodhura kane marre masen e penalizimit te shoqerise sone n menyre arbitrare.
- Ne aktin administrativ nuk pershkruhet apo disponohet asnje fakt i cili te vertetoje se ne momentin e kontrollit nuk leshohet kupon tatimor.
- Edhe ne akt konstatimin e dyte, seria 0161774, date 22.12.2012, inspektoret kane konstatuar se mjeti furgon Ford me targe VL 9612 C, ne pronesi te paditesit u gjet ne rruge me kasen fikur dhe sipas inspektoreve tatimor do te thote qe nuk leshon kupon tatimor.
- Ne akt konstatimin e mesiperme inspektori nuk shpjegon se cfare malli po shitet, vleren e mallit te likujduar dhe te konstatuar prej kontrollit, nuk eshte kryer inventari fizik per diferenca te mundshme si dhe nuk eshte shprehur nese eshte leshuar fatura tatimore per transakcionin e cila ne zbatim te ligjit tatimor ne fuqi duhet te leshohet sa here ekziston nje transaksion midis dy subjekteve.
- Ne legjislacionin tatimor nuk parashikohet ne asnje rast penalizimi ndaj subjekteve ne rastet kur eshte e fikur pajisja fiskale e cila funksionon me bateri qe mund te jete e fikur per shume arsye. Inspektoret kane dale ne konkluzion duke penalizuar subjektin pa dhene asnje shpjegim te bazuar ne ligj, duke u mjaftuar vetem me faktin qe pajisja fiskale per momentin ka qene e fikur, fakt ky qe ne baze te ligjit nuk perben penalitet.

Prapesimet e pales se paditur gjate gjykimit ne shkalle te pare

- Gjykimi i kesaj ceshtje eshte zhvilluar ne mungese te pales se paditur, megjithese gjykata beri te mundur zhvillimin e gjykimit ne respektim te parimit te kontradiktoritetit, parim ky i cili eshte sanksionuar ne dispozitat e K. Pr. Civile, ne respektim te se drejtes se gjithsecilit per ti bere te njohur pales kundershatare mjetet dhe faktet mbi te cilat mbeshtesin pretendimet e tyre.

Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë pasi ka shqyrtuar çështjen ka pranuar kerkese padine duke arsyetuar :

B. Arsyetimi i Gjykates se Shkalles se Pare Vlore

..... Nga rrethanat e faktit dhe nga analiza ligjore qe i behet dispozitave te mesiperme Nenit 324, 328 te Kodit te Procedurave Administrative, si dhe neni 106 e vijues te Ligjit me Nr.9920, date 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise.

Nga procesi gjyqesor, Njoftim i Vleresimit per Detyrimet me Nr.1292, date 23.01.2012 leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore dhe Vendimi Nr.3171/1, date 20.01.2012 leshuar nga Drejtoria e Apelimit Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve rezultojne me probleme ligjore thelbesore procedurale. Keto organe administrative kane nxjerre keto akte administrative me pasoja jo te vogla per paditesin dhe nuk kane dhene arsytim bindes apo prove mbeshetese. Inspektoret e pales se paditur kane pretenduar se personi juridik nuk ka leshuar kupona tatimor gjate shitjeve te kryera, fakt ky sipas tyre i provuar me gjetjen e fikur te kases fiskale. Ne kete rast eshte perpiluar nje akt konstatimi dhe me pas eshte leshuar Njoftimi i Vleresimi te Detyrimeve Tatimore. Mirepo pretendime te tilla prej pales se paditur mund te behen te besueshme kur ato nuk kane kryer procedura te metejshme per te bere te vertetuëshem nje fakt te tille. Rezultoi e provuar se automjeti me targa VL 9612 C, ne pronesi te subjektit te lartpermendur tregton mallrat e fatures se shoqerimit me nr.8311178, date 22.11.2011 furnizuar nga i njeiti subjekt me SNO28185-06-08, ne rrugen Siri Kodra, ku u gjet gjate tregtimit kasa jashte funksionit (e fikur) dhe nuk leshonte kupon tatimor gjate shitjeve qe kryen. Nga ana e Inspektoreve te Kontrollit ne Sektorin e Verifikimit te Terrenit duhej te konstatohej se cili mall u shit, sa u shit, kujt po i shitej. Nese do te ishim perpara shitjes se mallrave atehere logjiksht duhej te kishim nje diference midis fatures se shoqerimit te mallit me nr.8311178, date 22.11.2011 dhe gjendjes faktike. Me te drejte pala paditese pretendon se "Nese do te kishte ndodhur qe subjekti jone te mos kishte leshuar fature tatimore e cila ne subjektet tregtare eshte e detyrueshme, ne cdo rast inspektoret do te merrnin mase sipas ligjit; a) me konfiskim apo b) me mosleshimin e fatuers tatimore. Inspektoret e pales se paditur nuk kane paraqitur asnje prove per te vertetuar kete pretendim. Kjo menyre konstatimi tejkalon procedurat normale te kontrollit ligjor sipas legjislacionit perkates, dhe shkon drejt abuzimit dhe arbitraritetit. Pala e paditur nuk mund te kryeje kontrole te tilla pa pasqyruar sakte dhe bindshem shkeljen konkrete nepermjet provueshmerise se gjendjes se faktit. Nga akt konstatimi rezultojne pasaktesi te dukshme. Nuk vertetohet ne asnje moment nese shoqeria paditese ka kryer shitje dhe keto shitje kryhen apo jo me kupona tatimor. Pavaresisht shenimeve perkatese te inspektoreve ne aktin e konstatimit, ne kete akt nuk jane hedhur ne menyre te plote dhe korrekte shkeljet e mundshme te gjetura tek shoqeria paditese. Vetem shenimi se nuk jane leshuar kupona tatimor nuk perben shkelje apriori. Cdo kundravajtje administrative duhet te evidentohet dhe te provohet ne menyre te plote. Gjykata konstaton nje shkelje te procedurave ligjore per shqyrtimin e ankimit administrativ qe shoqeria paditese ka paraqitur prane Drejtorise se Apelimit Tatimor rezulton edhe ai me te meta per faktin se nga kjo instance me e larte administrative jane marre apriori si te mireqena konstatimet e Drejtorise Rajonale Tirane. Ne raste te tilla pala e paditur duhet te zhvilloje nje proces administrativ te plote duke analizuar te gjitha pretendimet e pales paditese. Refuzimi apriori i ketyre ankimeve perben nje shkelje te dispoazitave ligjore per shqyrtimin e ankimit administrativ si dhe parimeve te se drejtes administrative.

Nga njoftimi i Vlersimit per Detyrimet me nr.4520, date 19.09.2012 leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore rezulton se DRT Vlore ka nxjerre urdherin kundrejt pales paditese per detyrimet tatimore ne zbatim te kerkesave te Ligjit 9920/2009 "Per procedurat Tatimore". Ky detyrim eshte i perbere nga gjoba qe inspektoret e pales se paditur DRT Vlore kane vendosur

gjobe per mosleshim te kuponit tatimor ne masen 300.000 leke. Nga vendimi nr.23569/1, date 04.12.2012 leshuar nga Drejtoria e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve rezulton se ky organ apelimi administrativ ka refuzuar ankimin e pales paditese ne lidhje me anullimin e penalitetit ne shumen prej 300.000 leke per periudhen 2012, njoftuar me aktin administrativ nr.4520 prot, date 19.09.2012 te DRT Vlore, per arsye se e konsideron ankimin te papranueshem pasi ka kaluar afati i ankimit administrativ. Nga seanca gjyqesore rezultoi e provuar se pala paditese me tu vene ne dijeni te ketij vendimi te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane, i eshte drejtuar kesaj gjykate me ankim brenda afatit 30 ditor. Rezulton e provuar se vendimi i sipercituar i Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane, ka dale me dt.04.12.2012, nderkohe qe sipas shenimeve te sekretarise se gjykates, kerkese padia eshte dorezuar me dt.31.12.2012. Rezultoi e provuar se Njoftimi i Vleresimit per Detyrimet, nr.4520, date 19.09.2012 leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore nuk i eshte njoftuar pales paditese ne nje nga format e parashikuara me ligj. Nuk rezultoi e provuar ne seancat gjyqesore qe ka marre pjese pala e paditur qe kjo e fundit te kete nisur me poste dergimin e aktit kundrejt paditesit, nderkohe qe pala paditese pretendoi ne seance qe me te marre dijeni per gjoben kam aplikuar menjehere me ankim ne Drejtorine e Apelimit Tirane, dhe me te drejte nga ana e kesaj te fundit nuk eshte marre ne shqyrtim ankimi im me arsyetimin qe eshte paraqitur jashte afatit. Gjykata cmoi se me te padrejte nuk eshte marre ne shqyrtim ankimi i pales paditese ne lidhje me Njoftimiin e Vleresimit per Detyrimet, nr.4520, date 19.09.2012, per arsye se kjo nuk mundi te argumentoje se ka kryer detyrimin ligjor per njoftimin e kesaj gjobe me nje nga menytrat e parashikuara nga ligji dhe konkretisht mjafton qe te provoje se ajo ka nisur njoftim vlresimin ne adresen e paditesit me sherbim postar rekomande. Barra e proves per te vertetuar njoftimin kundrejt pales paditese. Per rrjedhoje edhe Vendimi nr.23569/1, date 04.12.2012 i dhene nga Drejtoria e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve rezulton me probleme ligjore thelbesore dhe proceduriale.

Gjykata cmon se aktet administrative objekt gjykimi vijne ne kundershtrim me proceduren e percaktuar me ligj duke i bere keto ne kundershtrim me dispozitat e K. Pr. Administrative si dhe ligjit per Kundravajtjet Administrative.

C . Vleresimi i Gjykates Adimistrative te Apelit

Kjo gjykatë, kryesisht, konstatoi se, çështja përbën lëndë për juridiksionin gjyqësor, dhe në kuptim të nenëve 7, 10 e 44 të ligjit nr. 49/2012, Gjykata Administrative e Apelit ka kompetencë lëndore dhe funksionale në shqyrtimin e çështjes objekt ankimi.

Gjykata pranoi për shqyrtim ankimin e palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore (në vijim do të gjendet e shënuar me inicialet DRT), pasi vlerësoi paraprakisht se ai plotëson kushtet formale dhe proceduriale të paraqitjes sikurse ka vlerësuar edhe Gjykata e shkallës së parë në vendimin për pranimin e ankimit. Ankuesi rezulton të jetë palë ndërgjyqesore në çështjen objekt gjykimi, dhe si i tillë legjitimohet të kundërshtojë vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë. Ankimi është depozituar në gjykatën që ka dhënë vendimin brenda afatit ligjor, afate keto të percaktuara në nenet 443/1 e 444/1 të K.Pr.Civile. Ankimi është i plotë në

elementët e formës dhe të përmbajtjes, është nënshkruar nga pala që e ka paraqitur, tregon palët ndërgjyqëse dhe të dhënat mbi vendimin që kundërshtohet. Vendimi i kundërshtuar perfshihet në llojet e vendimeve të paankimueshme të përcaktuara shprehimisht në nenin 45 të ligjit nr 49/2012, por kjo nuk përben shkak për mospranimin e ankimit pasi ankimi është paraqitur para datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr 49/2012 i cili kufizon të drejtën e ankimit në vartësi të vlerës së aktit administrativ të kundërshtuar më padi. E drejta e ankimit në rastin konkret është një e drejtë e fituar dhe si e tillë nuk mund të cenohet.

Referuar shkaqeve të parashtruara në ankim, analizës së rrethanave të faktit dhe të ligjit, bazuar në kërkimet e paditësit dhe provat e pranuar për shqyrtim nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit vlereson se ankimi i paraqitur nga pala e paditur, përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 50 gërma "c" të ligjit nr 49/2012 që motivojnë cenimin e vendimit nr. 2269 date 16.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndryshimin e tij dhe rrezimin e padisë .

Rezulton nga provat e administruara gjatë hetimit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e shkallës së parë se Shoqëria "Shqipëria 2 sh.p.k". ushtron aktivitetin e saj me objekt: tregtim i materialeve të ndryshme. Ky subject është regjistruar si tatimpagues pranë DRT Vlorë ku ka edhe selinë e tij.

Mbi bazën e kontrollit të ushtruar nga inspektorët e verifikimit në terren të DRT Tiranë, në ambjentet e tregtimit të mallrave nga subjekti tatimpagues Shqipëria 2A shpk, në datat 22.12.2011 e 24.08.2012, DRT Vlorë ka nxjerrë aktet administrative Njoftim Vlerësimi Nr 1293 datë 23.01.2012 dhe nr.11520 datë 19.09.2012.

Pasi është vënë në dijeni të këtyre akteve, në ushtrim të të drejtës së ankimit administrativ parashikuar nga nenet 106 e vijues të Ligjit nr 9920/2008 "Për procedurat tatimore në RSH", paditësi i ka kundërshtuar ato në Drejtorinë e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve Tiranë. Kjo e fundit ka vendosur lënien në fuqi të aktit administrative Njoftim Vlerësimin Nr 1293 datë 23.01.2012, dhe refuzimin e ankimit për kundërshtimin e Njoftim Vlerësimin Nr 11520 datë 19.09.2012, me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me të drejte ka pranuar për shqyrtim padinë e paditësit për të dy aktet e kundërshtuara, pasi nuk është vertetuar nga pala e paditur se ankimi administrative për kundërshtimin e Njoftim Vlerësimit Nr 11520 datë 19.09.2012 ishte paraqitur jashtë afatit 30 ditor.

Lidhur me detyrimin e gjykatës për të verifikuar nëse, ankimi është refuzuar nga DAT, pa qene në kushtet e ligjit për këte vendimarrje, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së lartë në vendimin Unifikues nr 3 datë 10.01.2008 kanë konkluduar:

45. Në argumentim sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara, në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore, arrijnë në përfundimin se:

a) gjykata, kur shqyrton një çështje me objekt anulim njoftim vlerësimi tatimor, nuk mund të mjaftohet vetëm me verifikimin e faktit të mosshqyrtimit të ankimit nga instancat kompetente administrative, për ta nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor.

Ajo, referuar pretendimeve të paditësit, është e detyruar të verifikojë paraprakisht nëse ankimi administrativ është paraqitur në afat dhe nëse këtij ankimi i janë bashkëngjitur dokumentet shoqëruese sipas nenit 55 të ligjit për procedurat tatimore.

b) Nëse gjykatës i rezulton se ankimi administrativ është paraqitur jashtë afatit dhe/ose mungojnë dokumentet shoqëruese sipas nenit 55 të ligjit dhe ky është shkaku i mosshqyrtimit në themel të ankimit nga organi administrativ, gjykata vendos konform neneve 36 e 59 të K.Pr.Civile nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

c) Në të kundërt, nëse gjykata konstaton se ankimi administrativ, ndryshe nga ç'pretendon organi administrativ, është ushtruar në afat dhe ka qënë i shoqëruar nga dokumentet e nevojshme sipas kërkesave të ligjit, nuk mund të refuzojë shqyrtimin e çështjes me arsyetimin se çështja nuk është shqyrtuar në themel nga organi administrativ.

d) Gjykata, siç theksuam më sipër, e nxjerr çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor vetëm kur paditësi, për faj të tij, nuk e ka paraqitur ankimin administrativ në afat ose nuk ka kompletuar dokumentet shoqëruese sipas ligjit (megjithëse organi administrativ e ka vënë në dijeni për të metat e ankimit). Nëse gjykatës i rezulton se jo për faj të paditësit (ankuesit) çështja nuk është shqyrtuar në themel nga organi administrativ, atëhere në zbatim të nenit 42 të Kushtetutës, nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, që garantojnë një proces të rregullt ligjor, është e detyruar të shqyrtojë çështjen në themel, duke qënë ajo që ka juridiksionin për shqyrtimin e çështjes.

Rezulton se DAT, ka vendosur refuzimin e ankimit të paditësit, pa verifikuar datën e marrjes dijeni nga subjekti për aktin administrative Njoftim Vlerësimit Nr 11520 datë 19.09.2012 dhe ne vartwsi te datwsi sw marrjes dijeni tw llogariste edhe afatin 30 ditor tw paraqitjes sw ankimit. DAT i referohet datës kur është nxjerrë akti nga DRT Vlore dhe jo datës kur ky akt i është dërguar subjektit pwr njoftim sipas nenit 69 tw ligjit nr 9920 "Pwr procedurat tatimore". Palet e paditura nuk kanë paraqitur asnjë prove qe verteton datën e dërgimit të aktit ne adresë të subjektit.

Në këto rrethana kjo Gjykatë vlerëson se ankimi i palës së paditur lidhur me mungesën e juridiksionit gjyqësor për kundërshtimin e Njoftim Vlerësimit Nr 11520 datë 19.09.2012 me arsyetimin se subjekti nuk ka ezauruar ankimin administrative, është i pabazuar ne prova.

Ndwrkohe, Gjykata Administrative e Apelit, i vlereson te drejta pretendimet e palës së paditur , të ngritura në ankim, lidhur me rrethanat qe kanë të bëjnë me ligjshmerinë e akteve administrative object gjykimi.

Konkluzioni i Gjykatës së Shkallës së parë se aktet jane të kundraligjshem është rrjedhoje e vleresimit të gabuar të provave dhe interpretimit jo korrekt te ligjit matërial e procedural. Gjykata e Shkallës së Parë i ka vlerësuar aktet si të kundraligjshem, ndërkohë nuk jep asnjë argument se ku qendron paligjshmeria.

Lidhur me procedure e nxjerrjes së akteve, Gjykata e shkallës së parë shprehet me terma të përgjithshem të tille si "Kjo menyre konstatimi tejkalon procedurat normale te kontrollit ligjor sipas legjislacionit perkates, dhe shkon drejt abuzimit dhe arbitraritetit", por nuk jep asnje argument ligjor se ku qendron shkelja e procedures nga organi administrative, cila dispozitiv konkrete e ligjit eshte shkelur duke e bere procesin administrative tw paligjshem, pwr pasojw aktin tw pavlefshem.

Gjithashtu nuk rezulton nga vendimi i Gjykatës së shkallës së parë nese aktet janë konsideruar te kundraligjshem për shkak të pabazueshmërisë në ligj (konsiderohen të tillë aktet që nuk përputhen me përmbajtjen dhe qëllimin e ligjit, janë rrjedhoje e vleresimit të gabuar të faktit, mungon ose është i vesuar vullneti i organit administrative etj), apo se fakti i pretenduar nga organi administrative nuk bazohet në prova(akti është i pathemeltë).

Edhe ne vleresim te rrethanave të faktit dhe të ligjit material, Gjykata e shkallës së parë përdor terminologji të përgjithëshme, si : *Nuk vertetohet ne asnje moment nese shoqeria paditese ka kryer shitje dhe keto shitje kryhen apo jo me kupona tatimor. Pavaresisht shenimeve perkatese te inspektoreve ne aktin e konstatimit, ne kete akt nuk jane hedhur ne menyre te plote dhe korrekte shkeljet e mundshme te gjetura tek shoqeria paditese. Vetem shenimi se nuk jane leshuar kupona tatimor nuk perben shkelje apriori. Cdo kundravajtje administrative duhet te evidentohet dhe te provohet ne menyre te plote, nga ana e inspektoreve duhej te konstatohej se cili mall u shit, sa u shit, kujt ju shit. Nese do te ishim para shitjes së mallrave duhej të kishte nje diference ndermjet faturës së shoqërimit të mallit dhe gjendjes faktike. Me te drejte pala paditëse pretendon se “ nese do të kishte ndodhur që subjekti jonë të mos kishte lëshuar faturë tatimore inspektoret do të merrnin masa sipas ligjit me konfiskim malli”.*

Ndërkohë, ndryshe sa ka argumentuar Gjykata e Shkallës së Parë, është provuar nga aktet e konstatimit qe kanë mbajtur inspektorët e palës së paditur, se paditësi është gjetur në dy raste duke tregtuar mallra, dhe për mallrat e tregtuar nuk leshon kupon tatimor. Ky fakt gjen pasqyrim ne aktet e konstatimit date 22.12.2011 ku eshte shenuar “ *Në rrugën Siri Kodra gjatë tregtimit të mallit kasa jsthtë funksionit e fikur*” dhe ne akt konstatimin datë 24.08.2012 ne të cilin është shënuar “ *gjatë kontrollit të ushtruar në orën 11.22 shitje der me derë, subjekti nuk leshon kupon tatimor*”. Në të dy akt konstatimet është përshkruar saktë vendi dhe koha e konstatimit të shkeljes, automjeti më të cilin kryhej tregtimi i mallrave, lloi i mallrave, faturat e shoqërimit të mallrave, si dhe personi qe kryentë tregtimin për llogari të tatimpaguesit, i cili ka refuzuar të nënshkruaje aktin e konstatimit në të dy rastet.

Shkelja e konstatuar ne akt konstatimet date 22.12.2011 e 24.08.2012, është parashikuar si kundrvajtje administrative nga neni 122 pika 1 gërma “b” e ligjit nr 9920 dhe denohet me gjobe herën e parë të konstatimit me 200.000 lekë dhe herën e dytë me 300.000 lekë per tatimpaguesit e rregjistruar si subjektet te TVSH-se dhe TF-se.

Per sa më sipër kjo gjykate cmon se aktet administrative objekt kundershimi me padi nga paditësi janë rrjedhoje e zbatimit te drejte te ligjit procedural e material nga administrata tatimore, për pasoje nuk ka shkaqe ligjore për ti shfuqizuar. Ne këto rrethana, ky kolegji vlereson se vendimi i Gjykatës së rrethit Gjyqësor Vlorë duhet të ndryshohet duke rrëzuar padine si e pabazuar në ligj e prova.

Edhe pse ne ankim nuk pretendohet për shkelje te procedurës se gjykimit të cilat passjellin pavlefshmerine e vendimit a te gjykimit, ky kolegji verifikoi kryesisht nese gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar brenda standarteve kushtetuese për një proces te rregullt ligjor, standarte këto të zberthyera në rregulla të hollesishme procedurale nga dispozitat e K.Pr.Civile dhe të Ligjit Nr 49/2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimit e mosmarrëveshjeve administrative*”. Nga ky verifikim u konstatua se procesi gjyqësor eshte

zhvilluar konform procedures se gjykimit administrativ, dhe nuk ka cenim të së drejtës per nje proces te rregullt ligjor. Aktet proceduriale te krijuara gjate gjykimit ne shkallë të parë janë në perputhje me kerkesat e K.Pr.Civile dhe Ligjit nr 49/2012.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në dhomë këshillimi, bazuar në nenet 49 e 50 germa “c” të ligjit Nr. 49/2012.

VENDOSI

-Ndryshimin e vendimit nr. 2269, datë 16.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

-Rrëzimin e padisë së paditësit Shoqëria “2 A” shpk.

-Kundër vendimit lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

Anëtar
Amarildo LAÇI
dv

Anëtare
Lindita SINANAJ
dv

Kryesues
Bari SHYTI
dv

Vertetohet njesia me origjinalin

*Kancelari
Leonard Steady
Steady*